



**KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË**

VENDIM

Nr 96 Datë 18.10, 2010

Për vendosjen e gjobave nga Inspektorët e Drejtorisë të Kontrollit të Territorit në rastet e konstatimit të shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kontrollit Territorit, bazuar në nenin 32 pika k, të Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" si dhe ligjit Nr.10 279 datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative", neni 6 "Shkeljet që perbejnë kundërvajtje administrative", pika b) Shkeljet që perbejnë kundërvajtje administrative parashikohen: me akte të keshillit bashkiak për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të vecanta, që kanë të lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njesitë territoriale perkatese, ku sipas ligjit ushtrojnë funksionet e veta.

VENDOSI :

Të miratojë llojet dhe nivelet e gjobave si më poshtë vijon:

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa licensë, autorizim apo leje përkatëse të jetë si më poshtë :	
a. Mospajisja me licensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti: <ul style="list-style-type: none"> • motokarro • transport udhëtarësh taksi (1+4) • transport udhëtarësh taksi (1+8) • mjete të tonazhit të lartë • hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tonazhit të lartë 	2.000 lek 10.000 lek 15.000 lek 20.000 lek 15.000 lek
b. Mospajisje me leje për tregëtimin me pakicë të karburanteve dhe njësisive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombulave të gazit	10.000 deri 20.000 lek
d. Mos pajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë.	1.000 deri 5.000 lek
e. Mos pajisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit	5.000 deri 20.000 lek
f. Mos pajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh"	10.000 deri 20.000 lek
g. Mos pajisje me leje për zenie të hapësirës publike <ul style="list-style-type: none"> • ekspozim malli • veprimtarive të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike 	5.000 deri 10.000 lek 5.000 deri 10.000 lek
h. Mospajisje me leje për vendosje reklame: <ul style="list-style-type: none"> • e thjeshte • elektronike 	5.000 deri 15.000 lek 15.000 deri 20.000 lek

i. Mosmarja e masave për izolimin e ambjentit për daljen e zhurmave nga ambjentet e lokaleve.	20.000 lek
---	------------

2. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore të jetë si më poshtë:

a. Dëmtim rruge	5.000 deri 10.000 lek
b. Carje rruge	10.000 deri 20.000 lek
d. Bllokim rruge	5.000 deri 20.000 lek
i. Dëmtim bordure	10.000 deri 20.000 lek
f. Dëmtim trotuari	10.000 deri 20.000 lek
g. Carje trotuari	10.000 deri 20.000 lek
h. Bllokim trotuari	5.000 deri 20.000 lek
j. Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete	10.000 deri 20.000 lek
k. Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit për punime në qytet :	
-persona juridik ose institucione shteterore	20.000 lek
-persona fizik	10.000 lek
-qytetar	5.000 lek

3. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor të jetë si më poshtë:

a. Lidhje e pamiraturar në rrjetin ajror	10.000 deri 20.000 lek
b. Dëmtim të shtyllave të ndriçimit	15.000 deri 20.000 lek
c. Dëmtim i ndriçuesve	10.000 deri 20.000 lek
c. Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montimin e reklamave, kapjen e kablove etj.	5.000 deri 10.000 lek
d. Dëmtim i traseve, kablove dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave	10.000 deri 20.000 lek
e. Ndërhyrje në kuadrot elektrik publik	10.000 deri 20.000 lek

4. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit:

a. Lidhje e pa miratuar në tubacion	10.000 deri 20.000 lek
b. Dëmtim i pusetave	10.000 deri 20.000 lek
c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje	10.000 deri 20.000 lek
5. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbëra dhe publike të jetë si më poshtë :	
a. Dëmtim i hapësirave publike të gjelberta	10.000 deri 20.000 lek
b. Dëmtim, prerje e pemëve	10.000 deri 20.000 lek
c. Zënie e hapësirës të gjelbër pa leje	5.000 deri 20.000 lek
d. Vendosje tabelash pankartash, banderolash pa leje	1.000 deri 10.000 lek
e. Vendosje posterash pa leje	100 deri 200 lek/copë
h. Mos ndërtimi i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane të subjekteve të ndërtimit për objektet mbi 5 kate	10.000 lek

6. Niveli i gjobave për inspektoriatin veterinar të jetë si më poshtë :

a. Për mishin e therur të tregtuar të pa certifikuar nga Inspektoriatin Veterinar	5.000 deri 10.000 lek
b. Mbajtja e kafshëve të prodhimit brenda territorit të Bashkisë.	10.000 deri 20.000 për herë të parë, për rast të përsëritur deri në konfiskim të kafshës
c. Në rast të mosmarjes së masave për izolimin kafshëve të luksit	2.000 deri 5.000 lek

8. Të ardhurat e realizuara nga mbledhja e gjobave do të ndahen sipas përcaktimit që ben ligji Nr.10 279 date 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet, Administrative”.

9. Shfuqizohet V.K.B. NR 95 date 19.09.2008 “Per Vendosjen e gjobave nga Inspektoret e Drejtorise se Kontroll Territorit ne rastet e shkeljeve dhe

kundervajtjeve administrative”. Mbeten në fuqi të gjitha gjobat e tjera që janë miratuar me ligj ose udhëzime bazuar ne Ligjin nr 10 279 date 20.05.2010 “Per Kundërvajtjet Administrative” dhe që nuk janë përmendur në këtë material.

10. Ngarkohet Drejtoria e Kontrollit te Territorit te realizoje evidentimin me regjister perkates te subjekteve dhe personave te penalizuar me gjoba bazuar ne nenin 18 te Ligjit nr.10 279 date 20.05.2010 “Per Kundërvajtjet Administrative” , Mbi kriteret dhe caktimin e llojit dhe te mases se denimit me gjobe.


11. Përfshihen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të posatshem.

12. Në zbatimin e ketij vendimi ngarkohen të gjitha Drejtoritë në Bashki e veçanërisht Drejtoria e Kontrollit te Territorit.

13. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

K R Y E T A R

Gjergji PENDAVINJI



Dixhitalizuar nga www.infocip.org